

VENDIM
Nr. 355, datë 20.5.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR,
TË PLANEVE RAJONALE DHE TË PROGRAMIT OPERACIONAL PËR
ZHVILLIMIN RAJONAL E KOHEZIONIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 8, 12, pika 5, e 13, pika 8, të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e procedurave për hartimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (në vijim “PKZHRK”), të planeve rajonale për zhvillimin rajonal dhe kohezionin (në vijim “PRZHRK”) dhe të programit operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin (në vijim “POZHRK”) të emërtuara bashkërisht si “dokumente të planifikimit e të koordinimit”, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së tyre me drejtimit e politikës kombëtare të zhvillimit rajonal e kohezionit nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës.

KREU II
**DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT E TË KOORDINIMIT DHE PROCEDURA E
HARTIMIT**

1. PKZHRK-ja dhe POZHRK-ja hartohen nga Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK) në cilësinë e organit përgjegjës për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. PRZHRK-ja hartohet nga bordi i monitorimit të zhvillimit rajonal përkatës, në cilësinë e organit përgjegjës, në nivelin e kufijve territorialë të rajonit zhvillimor.

3. Në cilësinë e sekretariatit teknik, Fondi Shqiptar i Zhvillimit siguron mbështetje administrative dhe teknike për përgatitjen e këtyre dokumenteve planifikuese e koordinuese.

4. Në kuadër të hartimit të dokumenteve të planifikimit e të koordinimit, organet përgjegjëse, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu, udhëzojnë punën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, për:

a) përgatitjen e analizës mbi gjendjen ekzistuese socioekonomike, territoriale e mjedisore, duke përfshirë vlerësimin e pabarazive ndërmjet rajoneve zhvillimore dhe/apo brenda tyre;

b) përcaktimin e objektivave strategjikë si mekanizëm për të adresuar problemet e identifikuara;

c) përcaktimin e drejtimeve, të prioritetëve dhe të paketave të ndërhyrjeve zhvillimore, që programohen për zbatim;

ç) vlerësimin e nevojave për financim dhe programimin e financimit të brendshëm e të huaj;

d) koordinimin ndërmjet sektorëve dhe institucioneve në nivel qendror e vendor;

dh) realizimin e procesit të konsultimit e të angazhimit të aktorëve dhe partnerëve zhvillimorë në rajone.

5. Dokumentet e planifikimit e të koordinimit hartohen në zbatim të orientimeve të politikës kombëtare të zhvillimit rajonal, duke garantuar përputhshmërinë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe marrëveshjet e bashkëpunimit e të financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave, Bashkimit Evropian, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe palëve të tjera, në rastet kur dhe për atë që sa ndikojnë në përmbajtjen e këtyre dokumenteve.

6. Dokumentet e planifikimit e të koordinimit i nënshtrohen procesit të konsultimit gjatë fazave të ndryshme të hartimit dhe ndjekin parimin e planifikimit e të koordinimit si proces pune në vazhdimësi, duke reflektuar, sipas rastit, kërkesat që burojnë nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe politika e kohezionit.

7. Organi përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit e të koordinimit, në përputhje me parimin e partneritetit, kryen bashkërendimin horizontal ndërmjet autoriteteve/aktorëve kombëtarë/ë të zhvillimit sektorial dhe bashkërendimin vertikal ndërmjet autoriteteve/aktorëve kombëtarë/ë dhe aktorëve të zhvillimit në nivel vendor e rajonal.

8. Për nevojat e hartimit të PKZHRK-së në nivel kombëtar, KKZHRK-ja mund të ngrejë grupe teknike/tematike pune me përfaqësues nga ministritë e linjës apo institucione të tjera qendrore, rajonale dhe vendore, që janë të përfshira në çështjet e zhvillimit rajonal.

9. Organet përgjegjëse, të mbështetura nga sekretariati teknik, organizojnë, gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe koordinimit në nivel kombëtar dhe/apo rajonal, konsultime me aktorë të zhvillimit rajonal, nëpërmjet takimeve konsultative, dëgjësave publike, platformave *online*, anketimeve, pyetësorëve apo formave të tjera të vlefshme të konsultimit publik.

KREU III

RISHIKIMI I DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT E TË KOORDINIMIT

1. Organi përgjegjës mund të rishikojë dokumentin e planifikimit e të koordinimit të zhvillimit rajonal, në rastet:

- a) e ndryshimeve në politikat e prioritetet e përgjithshme kombëtare qeverisëse zhvillimore;
- b) e ndryshimit të drejtimeve të zhvillimit, të përcaktuar në Dokumentin e Politikës Kombëtare të Zhvillimit Rajonal e Kohezionit;
- c) e ndryshimeve të paparashikuara demografike;
- ç) e ndryshimeve në situatën sociale, ekonomike, mjedisore apo qeverisëse të vendit;
- d) e situatave të jashtëzakonshme, apo të emergjencave kombëtare/rajonale;
- dh) e ndarjeve të reja administrative e territoriale.

2. Rishikimi i PKZHRK-së, i PRZHRK-së dhe i POZHRK-së paraprihet nga analiza e ndërmarrë nga organi përgjegjës, duke garantuar përputhshmërinë me përcaktimet në dokumentet pararendëse të një niveli më të lartë hierarkik.

3. Procedura e ndjekur për rishikimin e dokumenteve të planifikimit e të koordinimit është e njëjtë me procedurën e miratimit të tyre, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

KREU IV

HARTIMI I DOKUMENTEVE PLANIFIKUESE DHE KOORDINUESE PËR CIKLIN PASARDHËS

1. Hartimi i dokumenteve planifikuese dhe koordinuese për ciklin pasardhës planifikues ndërmerret nga organi përgjegjës të paktën 1 (një) vit përpara përfundimit të periudhës planifikuese paraardhëse.

2. Hartimi i dokumenteve të planifikimit e të koordinimit për ciklin e ri planifikues bëhet duke evidentuar gjetjet dhe mësimet e nxëna gjatë vlerësimit përfundimtar mbi zbatimin e ndikimin e dokumenteve planifikuese në përfundim.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen zëvendëskryeministri, Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu